Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

PRISHTINA

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**KOMUNA E PRISHTINËS**
**KRYETARI I KOMUNËS**

21-12-2018
14-020/01-0299021/18

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008) dhe të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

**V E N D I M**

**I.** Miratohet Vendimi për caktimin e grupit punues për projektin SORI, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Prishtinës dhe organizatës "Doutche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit" GIZ - GmbH.

**II.** Grupi punues i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. Premtime Preniqi, Njësia komunale për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, koordinatore,
2. Lulzim Vrapca, Zyra për komunitete dhe kthim, anëtar,
3. Igballe Perçuku – Tahiri, Drejtoria e Shëndetësisë, anëtare,
4. Hyzri Bunjaku, Sektori për burime njerëzore, anëtar,
5. Leunora Spahiu, Drejtoria e Mirëqenies Sociale, anëtare,
6. Ardiana Ismaili, Drejtoria e Arsimit, anëtare,
7. Qëndron Arifi, INPO, anëtar.

**III.** Grupi punues nga pika II e këtij vendimi, ka për detyrë:

a) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për identifikimin, arritjen dhe qasjen tek grupet më të prekura të popullsisë në komunat përkatëse;
b) Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve në nivel komunal të të gjithë akterëve për të drejtat e njeriut, respektivisht të drejtat sociale;
c) Asistim në formimin dhe funksionimin e grupit punues ndërsektoral në nivel komune, sipas termave të referencës që do të përcaktohen për këtë grup;
d) Asistim në ofrim cilësor të të gjitha shërbimeve për grupet më të prekura (fushat dhe temat e trajnimit do të identifikohen ndërmjet GIZ-së dhe Komunës);
e) Ngritja e kapaciteteve për identifikimin, aplikimin dhe implementimin e fondeve për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në nivel komunal);

f) Asistencë në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me OJQ të ndryshme vendore dhe rajonale;
g) Përkrahje për shërbimet në terren dhe aktivitetet vetëdijesuese (duke përfshirë këtu edhe shpërndarjen e informatave dhe kampanjave vetëdijesuese);
h) Asistencë në shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në kuadër të arritjes dhe qasjes në grupet e prekura, por edhe ofrimin e shërbimeve, sipas nevojës, për këto grupe;
i) Monitorimi i aktiviteteve të parapara, ndryshimi apo përshtatja sipas kërkesave në terren.

**IV.** Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, grupi punues i raporton Kryetarit të Komunës.

**V.** Grupi punues zgjedh kryesuesin/en e grupit, që do të kujdeset për koordinimin e aktiviteteve të grupit.

**VI.** Mandati i grupit punues është deri më 31.12.2019.

**VII.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U dorëzohet:**

- **Anëtarëve të grupit punues;**
- **Qendrës për shërbime me qytetarë;**
- **Në dosje.**

**Kryetari i Komunës**
**Shpend Ahmeti**